

LIGJ
Nr.8224, datë 15.5.1997

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË TË BASHKISË DHE TË KOMUNËS

(ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

(ndryshuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

Në Republikën e Shqipërisë pranë bashkive e komunave organizohet dhe funksionon policia e bashkisë dhe e komunës, për detyrat që kryen, ajo është në vartësi të kryetarit të bashkisë e të komunës dhe nën mbikëqyrjen e kontrollin ligjor të prefektit.

Policia bashkiake dhe e komunës është organ ekzekutiv që ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit të bashkisë a të komunës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që nuk janë në kompetencë të autoriteteve të tjera shtetërore.

Policia e bashkisë dhe e komunës nuk është pjesë përbërëse e Forcave të Armatosura.

Neni 2

(ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

Policia e bashkisë dhe e komunës, si rregull, ka këtë strukturë:

- inspektori - shefi i seksionit të policisë në bashki ose në komunë;
- policë.

Në këshillin e rrethit emërohet kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë e të komunës.

Neni 3

(ndryshuar fjalë në paragrafin e parë, shtuar fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

Kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë e të komunës emërohet e shkarkohet në detyrë nga prefekti, me propozim të kryetarit të këshillit të rrethit, pasi të jetë marrë pëlqimi nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë e të komunës duhet të jetë diplomuar në Akademinë e Policisë. Ai kryen me autorizim të prokurorit edhe funksione të oficerit të policisë gjyqësore.

Neni 4

Në policinë e bashkisë dhe të komunës mund të shërbejnë shtetas shqiptarë të titulluar oficerë ose policë sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministri i Rendit Publik.

Neni 5
(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

Kryetari i bashkisë apo i komunës emëron dhe shkarkon shefin e seksionit dhe inspektorët dhe policët të cilët përzgjidhen nga një komision i posaçëm që kryesohet nga kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë e të komunës dhe përbëhet nga një i deleguar i prefektit, si dhe një përfaqësues i komisarariatit të policisë.

Neni 6

Kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë e të komunës përgjigjet për kryerjen e shërbimeve të kësaj policie në përputhje me ligjin.

Neni 7

Punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës i nënshtrohen kualifikimit dhe trajnimit.

Neni 8
(ndryshuar fjalë dhe hequr fjalë në pikën 1, ndryshuar pika 9, shfuqizuar pika 14 me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

Policia e bashkisë dhe e komunës ka për detyrë:

1. Të sigurojë zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë (komunës) dhe të këshillit që kanë të bëjnë me sigurimin e rendit e të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike.
2. Të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së bashkisë apo të komunës, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.
3. Të sigurojë zbatimin e urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë (komunës) në lidhje me personat juridikë ose fizikë, që nuk plotësojnë konform ligjit detyrimet financiare e fiskale, ndaj bashkisë apo komunës, si dhe çdo detyrim tjetër pasuror ndaj tyre.
4. Të mbikëqyrë e verifikojë nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve bashkiake.
5. Të konstatojë e të parandalojë ndotjet e mjedisit, hedhjet e mbeturinave të ndryshme, si dhe të sinjalizojë kryetarin e bashkisë (komunës) për shfaqjet e parazitëve të dëmshëm e të rrezikshëm si dhe për rastet e shfaqjes së epidemive.
6. Të ndalojë, shmangë e prishë ndërtimet e paligjshme, të ndalojë zëniet e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të bashkisë apo komunës, si dhe të organizojë lirim të tyre.
7. Të kujdeset për qetësinë publike, duke shmangur zëniet, mënjanuar zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerëzve, autoparlantet e radiove e magnetofoneve, rënia pa vend e burive të automjeteve në rrugë, banesa, plazhe e mjedise të tjera publike, që sjellin shqetësime për të tjerët.
8. Të marrë masa për ruajtjen e rendit, kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panaire, ceremoni publike, artistike, fetare e sportive, në kinema, teatro, pallate e salla sportive, objekte të kultit dhe në mjedise të tjera publike.
9. Të inspektojë respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në mjedise publike.
10. Të kujdeset për respektimin e orarit të shërbimit të njësive tregtare, bufeve, restoranteve, bilardove, lojërave të fatit e të objekteve të tjera me veprimtari publike, si dhe për zbatimin nga ana e tyre të rregulloreve apo urdhërave të nxjerra nga kryetari i bashkisë apo komunës.
11. Të kontrollojë marrjen e masave të sigurisë që parandalojnë fatkeqësitë e ndryshme natyrore, si dhe të ndihmojë në kapërcimin e tyre duke u dhënë gjithashtu ndihmë të dëmtuarve në

raste urgjence.

12. Të marrë masa të përkohshme ndaj të sëmurëve psikikë në gjendje të rëndë, që krijojnë shqetësime për rendin publik.

13. Të kujdeset për ruajtjen e afisheve, njoftimeve e shpalljeve publike, si dhe heqjen e atyre të paligjshme ose të paautorizuara.

14. Shfuqizuar.

Neni 9

Për rastet kur nevojitet zbatimi forcërisht i kompetencave, komandanti i policisë së bashkisë a të komunës njofton me shkrim 5 ditë përpara personin e interesuar.

Neni 10

Kur gjatë kryerjes së shërbimit konstatohen elemente të veprave penale, punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale marrin masa për shoqërimin e autorëve në komisariatit e policisë, ruajnë vendin e ngjarjes, fiksojnë dëshmitarët dhe ruajnë provat deri në ardhjen e policisë gjyqësore.

Neni 11

(shtuar fjalë me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

Punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës, në zbatim të kompetencave të tyre, kanë të drejtë të thërrasin në mjediset e policisë të bashkisë ose të komunës shtetas të ndryshëm që kanë shkelur dispozitat e këtij ligji.

Neni 12

(ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

Kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë dhe të komunës ka në vartësi edhe inspektoratin e Mbrojtjes nga Zjarri, i cili funksionon në nivel rrethi.

Neni 13

Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë.

Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmuor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 14

(shtuar fjalë me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

Policia e bashkisë dhe e komunës ka uniformën e saj, të ndryshme nga policia e shtetit e cila miratohet nga ministri për Pushtetin Lokal.

Punonjësit e saj kanë shenjë dalluese dhe numrin personal.

Punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës pajisen me armë.

Pajisja me armë, mënyra e ruajtjes dhe e mbajtjes së saj rregullohen me akte të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 15

Ministri i Rendit Publik miraton rregulloren tip të policisë së bashkisë dhe të komunës.

Neni 16

Në raste nevojë, kur çmohet e domosdoshme për ruajtjen e rendit, shefi i komisariatit të policisë dhe kryetari i bashkisë apo komunës mund të bashkërendojnë veprimet e policive me miratim të prefektit.

Neni 17

Struktura e policisë së bashkisë dhe të komunave, numri, pagat dhe shpenzimet buxhetore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës gëzojnë mbrojtje të njëjtë ligjore me punonjësit e policisë së shtetit.

Neni 19

(shtuar fjalë me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998)

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Rendit Publik dhe Ministri për Pushtetin Lokal të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 20

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi më 15 korrik 1997.

Shpallur me dekreten nr.1801, datë 22.5.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha